

**AMF synon përfshirjen në projekte për zhvillimin dhe forcimin e rolit të saj mbikëqyrës dhe rregullator në tregjet**

### Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-maj 2019
- Tregtimi i titujve në Bursën ALSE

### Zhvillime të tjera

- AMF, pranë studentëve të Kolegjit Universitar “Logos” për rritjen e edukimit financiar
- Takim me Bankën Botërore mbi zhvillimin e tregjeve dhe mbikëqyrjen efektive të tyre
- AMF synon krijimin e një udhëzuesi për sigurimet gjithëpërfshirëse
- Sigurimi i pronës, një mundësi e mirë për t’u mbrojtur nga të papriturat e natyrës
- AMF publikon paralajmërimin e njoftuar nga Komisioni i Letrave me Vlerë të Qipros (CYSEC)
- Takimi i katërt i grupit të punës për Tregun e Kapitalit nga vendet e Ballkanit Perëndimor
- AMF rrit kapacitetet njerëzore nëpërmjet trajnimeve

### Edukimi i Konsumatorit

- Kategoritë dhe fazat e tregtimit në Bursë

### Botime Profesionale

### Lajme Ndërkombëtare

- Bullgari
- Hungari
- Rumani
- Serbi
- Slloveni
- Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

## AMF synon përfshirjen në projekte për zhvillimin dhe forcimin e rolit të saj mbikëqyrës dhe rregullator në tregje

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka, një ndër objektivat e tij kryesore, përfshirjen në projekte të ndryshme zhvillimore për të forcuar kapacitetet e tij mbikëqyrëse dhe për të rritur rolin e tij rregullator.

Gjatë muajit qershor 2019, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Koçi ka zhvilluar takime me përfaqësues të disa organizmave ndërkombëtarë, si Banka Botërore dhe Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare (FSVC) për t'i falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm dhe për të paraqitur më tej mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen. Z. Koci nënvizoi në këto takime mbështetjen e madhe të ekspertëve më të mirë ndërkombëtarë të tregjeve në mbikëqyrje, të cilat kanë ndihmuar në hartimin e disa projektligjeve të rëndësishme dhe rritjen më tej të kapaciteteve të stafit të Autoritetit.

Pas përfundimit me sukses të projektit “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”, me financimin e Sekretariatit Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO), si edhe mjaft projekteve të mbështetura nga FSVC, stafi i AMF-së ka kapacitetet teknike për të realizuar projekte të tjera zhvillimore. Drejtuesit dhe ekspertët e AMF-së po studiojnë nevojat që kanë tregjet nën mbikëqyrje për projekte të reja zhvillimore.

Në kuadër të zbatimit të strategjisë 5-vjeçare për “Zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje” AMF vlerëson të rëndësishëm projektet e reja që priten të nisin, si për tregun e sigurimeve, ashtu edhe për tregun e kapitalit. Gjithashtu, AMF do të thellojë bashkëpunimin me organizma të tjerë të huaj për të përfituar nga zhvillimet teknologjike dhe ndërthurja e tyre në tregjet financiare jobankare. Duke qenë vend anëtar edhe në disa nga organizmat ndërkombëtarë të specializuar për tregjet financiare, AMF do të përdorë praktikat më të mira dhe risitë teknologjike që ofrohen për të arritur zhvillime efektive dhe të qëndrueshme të tregjeve financiare jobankare në vend dhe për te ecur drejt standardeve evropiane.

Autoriteti i  
Mbikëqyrjes  
Financiare ka, një  
ndër objektivat e tij  
kryesore, përfshirjen  
në projekte të  
ndryshme zhvillimore  
për të forcuar  
kapacitetet e tij  
mbikëqyrëse dhe për  
të rritur rolin e tij  
rregullator.

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-maj 2019


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për janar-maj 2019 kapën vlerën mbi 6,755 milionë lekë, ose 7.61% më shumë se në periudhën janar-maj 2018. Gjatë periudhës janar-maj 2019, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 482,741 me një rritje 5.22% krahasuar me periudhën janar-maj 2018.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.19 % të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 7.23% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.57%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 40.25% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 59.75% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-maj 2019, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 2,342 milionë lekë, ose 3.73% më shumë se në periudhën janar-maj 2018.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për janar-maj 2019 kapën vlerën mbi 6,755 milionë lekë, ose 7.61% më shumë se në periudhën janar-maj 2018.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-maj 2019



## Tregtimi i titujve në Bursën ALSE, qershor 2019

Sipas të dhënave statistikore të Bursës ALSE, gjatë muajit qershor 2019, në këtë bursë janë tregtuar Bono Thesari në vlerën 159,344 lekë dhe Obligacione në vlerën prej 223,350,640 lekë. Duke analizuar volumin dhe vlerën e tregtuar, gjatë këtij muaji, kanë dominuar transaksionet e *on-exchange*.

Nga të dhënat e tregtimit në ALSE, për muajin qershor 2019, sipas llojit të transaksioneve, kanë dominuar si në numër, volum dhe vlerë transaksionet e ekzekutuara për llogari të klientëve, krahasuar me transaksionet e ekzekutuara për llogari të vetë Anëtarëve të Bursës ALSE.

### Tregtimi i Titujve të Qeverisë të R.Sh. në Bursën ALSE

Lloji i Transaksionit	Vlera e Tregtimit (në Lekë)	
	Bono Thesari	Obligacione Thesari
Për anëtarët	0	102,560,000
Për klientët	159,344	120,790,640
Individë	159,344	2,263,140
Persona Juridike	0	118,527,500
<b>TOTAL</b>	<b>159,344</b>	<b>223,350,640</b>

## ZHVILLIME TË TJERA

### AMF, pranë studentëve të Kolegjit Universitar “Logos” për rritjen e edukimit financiar

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi më datë 12 qershor, një leksion të hapur me studentë të Fakultetit Ekonomik të Kolegjit Universitar “Logos”. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të “Strategjisë për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet financiare nën mbikëqyrje”, me qëllim kryesor rritjen e edukimit financiar të studentëve.



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe rektorja e Kolegjit Universitar “Logos”, Prof. Dr. Nikoleta Mita gjatë nënshkrimit të marrëveshjes

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi më datë 12 qershor, një leksion të hapur me studentë të Fakultetit Ekonomik të Kolegjit Universitar “Logos”.

Aktivitetit i parapriu nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi mes Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Kolegjit Universitar “Logos”, nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe rektorja e Kolegjit Universitar “Logos”, Prof. Dr. Nikoleta Mita. Në fjalën e mbajtur, Z. Koçi theksoi se edukimi financiar për tregjet nën mbikëqyrje është një nga prioritetet e punës së Autoritetit. Ai u shpreh se bashkëpunimi i vendosur nëpërmjet marrëveshjes së nënshkruar me Kolegjin Universitar “Logos” është një mundësi shumë e mirë për të gjithë studentët për t’u përfshirë në nismat e Autoritetit, për zhvillimin e praktikave mësimore pranë AMF ose në shoqëritë që operojnë në tregjet financiare nën mbikëqyrje.

Rektorja e Kolegjit Universitar “Logos”, Znj. Mita e vlerësoi nismën e Autoritetit për rritjen e edukimit financiar të studentëve dhe u shpreh e bindur se marrëveshja e nënshkruar do të jetë me përfitim reciprok. Në orën e hapur të leksionit, studentët u njohën me rolin dhe funksionet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si një institucion i pavarur, si edhe në lidhje me zhvillimet kryesore në tregjet nën mbikëqyrje. Gjithashtu studentët u anketuan nga Autoriteti për matjen e njohurive të tyre financiare.



## Takim me Bankën Botërore mbi zhvillimin e tregjeve dhe mbikëqyrjen efektive të tyre

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Z. Ervin Koçi priti në një takim përfaqësues të Bankës Botërore për të diskutuar në lidhje me një projekt të ri asistence për zhvillimin e tregjeve dhe mbikëqyrjen efektive të tyre.



*Gjatë zhvillimit të takimit*

Z. Koçi falenderoi përfaqësuesit e Bankës Botërore për mbështetjen e vazhdueshme në drejtim të Autoritetit në kuadër të kualifikimit profesional dhe zhvillimit të kapaciteteve mbikëqyrëse.

Përfundimi me sukses i projektit “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”, me financimin e Sekretariatit Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO) në mars 2019 i hapi rrugën bashkëpunimeve të tjera.

Z. Koçi falenderoi përfaqësuesit e Bankës Botërore për mbështetjen e vazhdueshme në drejtim të Autoritetit në kuadër të kualifikimit profesional dhe zhvillimit të kapaciteteve mbikëqyrëse. Ai u shpreh se falë mbështetjes së ekspertëve më të mirë ndërkombëtarë të fushës janë hartuar disa projektligje të rëndësishme dhe janë rritur më tej kapacitetet e stafit të Autoritetit.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv e vlerësoi si shumë të rëndësishëm projektin e ri që pritet të nisë me mbështetjen e Bankës Botërore, në kuadër të zbatimit të strategjisë 5-vjeçare për “Zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje”. Projekti do të shtrihet jo vetëm në tregun e kapitaleve, por edhe atë të sigurimeve.

Përfaqësuesit e Bankës Botërore u shprehën shumë të kënaqur për bashkëpunimin e deritanishëm me Autoritetit dhe theksuan gadishmërinë e tyre për projektin e ri të asistencës.

## AMF synon krijimin e një udhëzuesi për sigurimet gjithëpërfshirëse

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi në datat 3-7 qershor një projekt për të rritur kapacitetet e tij mbikëqyrëse dhe rregullatore për mikrosigurimet. Projekti u financua nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe me asistencën teknike të ekspertit z. Peter Wrede nga Shërbimi Vullnetar i Korpusit Financiar, FSVC.

Gjatë projektit, specialistë dhe drejtues drejtorive të ndryshme në AMF, diskutuan me ekspertin e huaj mbi konceptet kryesore të mikrosigurimeve, këndvështrimin aktuarial të tyre, rolin e inovacioneve teknologjike në shpërndarjen dhe promovimin e produkteve të reja në tregun e sigurimeve, si edhe mbikëqyrjen më efektive të tyre.

Eksperti Z. Wrede ka një përvojë të gjatë në tregun e sigurimeve dhe të shtrirë në disa vende si në Gjermaninë e më pas në vende të Azisë dhe Afrikës. Prej vitit 2012 ai është pjesë e projekteve të Bankës Botërore. Ai zhvilloi takime edhe me shoqëritë e sigurimeve që veprojnë në vend për të njohur tregun dhe për të parë mundësitë që ato kanë për shërbime dhe produkte të reja për konsumatorin. Takime u zhvilluan me përfaqësues të sektorit bujqësor dhe agropërpunues, si degë të mundshme ku mund të përfshihen mikrosigurimet.

Bazuar në kushtet aktuale të tregut të sigurimeve dhe mundësisë së shtrirjes së tyre, gjatë projektit u diskutua si pjesë e rëndësishme kombinimi i mbikëqyrjes efektive me mbrojtjen e konsumatorit në sigurime.

Projekti synon krijimin edhe të një udhëzuesi për zhvillimin e sigurimeve gjithëpërfshirëse në Shqipëri, si mundësi për zgjerimin e tregut të sigurimeve dhe në zbatim të Strategjisë për zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje 2018-2022.

AMF e ka në qendër të vëmendjes zgjerimin e tregut dhe mbrojtjen e konsumatorëve në sigurime. Ky projekt është në vazhdim të punës së mëparshme të AMF-së për nxitjen e mikrosigurimeve në kuadër të projektit zhvilluar me mbështetjen e A2i.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi në datat 3-7 qershor një projekt për të rritur kapacitetet e tij mbikëqyrëse dhe rregullatore për mikrosigurimet.


## Sigurimi i pronës, një mundësi e mirë për t'u mbrojtur nga të papriturat e natyrës

Një ndër mundësitë që ofron tregu i sigurimeve është edhe mbrojtja nga ngjarjet e vështira natyrore, të cilat mund të sjellin pasoja edhe në pronën e qytetarëve apo bizneseve. Sigurimi i pronës është një nga konceptet e reja që ka hyrë në marrëdhëniet financiare të qytetarëve me pronën e tyre. Kjo, në shumicën e rasteve, është e lidhur edhe me detyrimet e kërkuara nga marrëdhëniet me bankat, për kreditë që merren nga qytetarët për blerjen e banesave.

Duke analizuar të dhënat e shoqërive që veprojnë në tregun e sigurimeve, vihet re se ritmet e rritjes së sigurimit të pronës nga zjarri dhe rreziqe të tjera shtesë, në vitin 2018 ka qenë mbi 9% krahasuar me vitin 2017. Ky ritëm rritjeje është si për numrin e kontratave të nënshkuara ashtu edhe për volumin e primeve të shkruara bruto.

Duke analizuar të dhënat e shoqërive që veprojnë në tregun e sigurimeve, vihet re se ritmet e rritjes së sigurimit të pronës nga zjarri dhe rreziqe të tjera shtesë, në vitin 2018 ka qenë mbi 9% krahasuar me vitin 2017.

Ecuria e volumit të primeve të shkruara bruto, sigurimi i ndërtesave 2014-2018 - (në 000 lekë)



Edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2019 janë lidhur 10459 kontrata për sigurimin e pronës, të cilat janë kryesisht për apartamente banimi. Treguesit statistikorë për tremujorin e parë të vitit 2019 japin një rritje prej 6.88% të numrit të kontratave të lidhura në periudhën janar–mars 2019, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Specialistët e tregut të sigurimeve vlerësojnë se faktorët që merren parasysh, kur sigurohet një pronë, lidhen me:

- Shumën e siguruar (vlera e apartamentit/biznesit);
- Llojin e pronës, ku ndarja mund të jetë në objekte industriale, hotele dhe restorante, dyqane dhe qendra tregtare, zyra administrative, etj.;



- Gjendjen fizike të pronës, viti i ndërtimit, masat e sigurisë, vendndodhja e saj, shqyrtimi i historikut të dëmeve të objektit të siguruar, etj.

Nga analiza e informacioneve të marra nga shoqëritë e sigurimit, vlerësohet se ndër objektet e siguruar, 75% e tyre i takon shtëpive të banimit dhe 25% e godinave të siguruar janë objekte biznesi.

### **AMF publikon paralajmërimin e njoftuar nga Komisioni i Letrave me Vlerë të Qipros (CYSEC)**



Komisioni i Letrave me Vlerë të Qipros (CySEC) ka paralajmëruar disa herë publikun se persona të pa autorizuar prezantohen si zyrtarë të Komisionit të Letrave me Vlerë të Qipros (CySEC) ose si përfaqësues të emëruar nga ky Autoritet, duke u kërkuar investitorëve para në këmbim të zgjidhjes fiktive të kërkesave për kompensimin e humbjeve që mund të pësojnë investitorët nga investimi tek një numër shoqërisht brokerimi të licencuara dhe mbikëqyrura nga Autoriteti i Qipros.

Me qëllim mbrojtjen e investitorëve në nivel ndërkombëtar, CySEC ka kërkuar nga të gjithë anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me vlerë të asistojnë në publikimin e këtij njoftimi.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si nënshkrues i Marrëveshjes Shumëpalëshe mes anëtarëve të IOSCO-s dhe si anëtar me të drejta të plota i kësaj organizate vlerësoi nevojën e publikimit të këtij njoftimi.

Fushata *online* mjaft e sofistikuar nga personat e paautorizuar po shndërrohet në një skemë mashtrimi, ku:

- Individë të cilët pretendojnë të jenë punonjës të Komisionit të Letrave me Vlerë të Qipros, apo konsulentë ligjorë të tij, apo punonjës të autoriteteve të tjera financiare Qipriote (Bankës Qendrore e Qipros) kontaktojnë investitorë të ndryshëm nëpërmjet e-maileve të cilët përmbajnë emrin, adresën, vulën dhe logon zyrtare të CySEC dhe gjithashtu edhe firmën e punonjësve të autoritetit;
- Premtojnë për kompensime mbi probleme të mundshme që investitorët kanë hasur me disa kompani (platforma tregtimi të letrave me vlerë të cilat ofrojnë produkte spekulative investimi).

AMF, duke u mbështetur në paralajmërimet e CySEC sqaron se Komisioni i Letrave me Vlerë të Qipros nuk dërgon kurrë këto lloj kërkesash tek investitorët apo tek publiku i gjerë, si dhe gjithashtu:

- Nuk kërkon asnjë të dhënë personale, apo financiare;
- Nuk ka të drejtë të mbledhë tarifa nga investitorë individualë, si dhe nuk ka të drejtë për të caktuar persona të tretë të veprojnë në këtë mënyrë në emër të tij;
- Nuk është i përfshirë, dhe nuk ka kompetenca të kërkojë kompensime në grup, në emër të të tretëve.

Shembull i një skeme të tillë paraqitet më poshtë:

*Rasti më i fundit i një skeme të ngjashme përfshinte një individ i cili hiqej si “Christos Sofroniou”, dhe kishte për qëllim të kontaktonte investitorë në vende të ndryshme (përfshirë edhe vendet e BE-së) dhe t’u mbushte mendjen atyre të paguanin tarifa ligjore për të marrë pjesë në programe të rreme për të rikuperuar humbjet nga platformat e investimit. Në këtë komunikim, logoja e CySEC përdorej në mënyrë të pa autorizuar. Ky individ përdorte adresën elektronike [contact@sofroniou-legal.org](mailto:contact@sofroniou-legal.org) si dhe numrat e telefonit +35725654263; +35799711917.*

AMF paralajmëron publikun të qëndrojë vigjilent në lidhje me komunikime të ngjashme nga çdokush i cili hiqet si përfaqësues i CySEC apo autoriteteve të ngjashme, dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të transferojë para për llogari të tyre.

Investitorët janë të lutur të kontaktojnë CySEC apo çdo autoritet tjetër nga i cili kontaktohen për të verifikuar autencitetin e komunikimit.

Tregohuni të kujdesshëm që të mos bini pre e mashtrimeve.

AMF paralajmëron publikun të qëndrojë vigjilent në lidhje me komunikime të ngjashme nga çdokush i cili hiqet si përfaqësues i CySEC apo autoriteteve të ngjashme, dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të transferojë para për llogari të tyre.

## Takimi i katërt i grupit të punës për Tregun e Kapitalit nga vendet e Ballkanit Perëndimor

Takimi i katërt i Grupit Punues për Tregun e Kapitalit / Tregjet Financiare pjesë e bashkëpunimit rajonal të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor i emërtuar WB6 u organizua nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), në Vjenë më 14 qershor.

Viti 2017 dhe 2018 ishin piketa të rëndësishme për zhvillimin e tregjeve të kapitalit të Ballkanit Perëndimor, brenda kontekstit të Planit Shumëvjeçar të Veprimit për Zonën Ekonomike Rajonale (MAP REA).

Grupi rajonal i punës për tregun e kapitalit do të synojë përparimin në kapitullin e tregjeve të kapitalit dhe strategjisë së përgjithshme të tregjeve financiare.

Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC) do të vazhdojë të koordinojë këtë qasje drejt përfitimeve më të mëdha për diversifikimin e sektorit financiar duke i shërbyer rritjes ekonomike, rritjes së vendeve të punës dhe duke përfshirë edhe lojtarë të tjerë në këtë fushë përveç tregjeve të kapitalit, si fondet e sigurimeve, fondet e investimeve, fondet e pensioneve, kapitalit të ndërmarrjeve dhe të tjerëve.

Puna do të përfshijë gjetjen e sfidave kryesore për zhvillimin e sektorit financiar, përgatitjen e masave adekuate për adresimin e këtyre sfidave dhe zbatimin e masave të dakorduara nëpërmjet mekanizmit koordinues të RCC (Grupi Punues për Tregjet Financiare) duke përfshirë autoritetet përkatëse të rajonit dhe palët e interesuara dhe partnerët e tjerë Banka dhe të tjerët). Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është anëtar i këtij grupi pune për tregjet e kapitalit.

### Seminar mbi zbatimin efektiv të kontrollit të brendshëm

Instituti për Kontabilitet, Auditim dhe Financa, IKAF, zhvilloi në datat 21 dhe 22 qershor, në Budva, Montenegro, seminarin mbi zbatimin efektiv të kontrollit të brendshëm. Disa nga temat që u trajtuan lidheshin me:

- Përkufizimin mbi kontrollin e brendshëm;
- Komponentët e kuadrit të kontrollit të brendshëm;
- Modelin e tre linjave të mbrojtjes;
- Përfitimet nga kontrolli i brendshëm dhe kufizimet e kontrollit të brendshëm.

Grupi rajonal i punës për tregun e kapitalit do të synojë përparimin në kapitullin e tregjeve të kapitalit dhe strategjisë së përgjithshme të tregjeve financiare.

—○○○—  
Gjatë ditëve të zhvillimit të seminarit u diskutua e shkëmbyen eksperiencia mbi pesë komponentët e një kuadri të fortë të Kontrollit të brendshëm që janë: Mjedisi i kontrollit; Vlerësimi i rrezikut; Aktivitetet e kontrollit; Informimi dhe komunikimi, si edhe Monitorimi.  
—○○○—

Gjatë ditëve të zhvillimit të seminarit u diskutua e shkëmbyen eksperiencia mbi pesë komponentët e një kuadri të fortë të Kontrollit të brendshëm që janë: Mjedisi i kontrollit; Vlerësimi i rrezikut; Aktivitetet e kontrollit; Informimi dhe komunikimi, si edhe Monitorimi.

**Mjedisi i kontrollit** është një grup standardesh, procesesh dhe struktura që ofrojnë bazë për kryerjen e kontrollit të brendshëm në të gjithë organizatën.

**Vlerësimi i rrezikut** përfshin një proces dinamik dhe përsëritës për identifikimin dhe analizën e rreziqeve. Çdo njësi ekonomike përballet me një sërë rreziqesh nga burimet e jashtme dhe të brendshme.

**Aktivitetet e kontrollit** janë veprimet e krijuara përmes politikave dhe procedurave që ndihmojnë në sigurimin e direktivave të drejtimit për të zbutur rreziqet në arritjen e objektivave.

**Informimi dhe komunikimi** - Informacioni është i nevojshëm për të kryer përgjegjësitë e kontrollit të brendshëm për të mbështetur arritjen e objektivave të saj.

**Monitorimi** - Vlerësimet e vazhdueshme, vlerësimet e veçanta ose disa kombinime të të dyjave, përdoren për të konstatuar nëse njëri nga pesë komponentët e kontrollit të brendshëm, duke përfshirë kontrollet për të zbatuar parimet brenda secilit komponent, është i pranishëm dhe funksionon.

Në përfundim të aktivitetit, pjesëmarrësit diskutuan rreth fushave kryesore që mund të përmirësohen në vendet përkatëse.

## Konferencë Vjetore për legjislacionin evropian në fushën e sigurimeve

Akademia e të Drejtës Evropiane (ERA) zhvilloi, më datat 6 dhe 7 qershor, në Trier, Gjermani, konferencën vjetore për legjislacionin evropian në fushën e sigurimeve. Çështjet e rëndësishme të trajtuara në konferencë ishin:

- Ndryshimet e fundit, përsa i përket *Solvency II*;
- Direktiva e re e sigurimit të detyrueshëm motorik;
- Mbrojtja e të dhënave personale dhe TI në sigurime;
- Informacion mbi *PAN-European Pension Product*;
- Ndikimi i Brexit në fushën e sigurimeve.

Gjatë konferencës u diskutua mbi ndryshimet/amendimet e akteve ligjore në fushën e sigurimeve, zhvillimet më të fundit, si dhe iniciativat ligjore në këtë fushë.

## Konferenca e IV-të vjetore për zhvillimet në skemat e pensioneve

Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS) zhvilluan në datat 3-4 qershor në Paris, Francë mbledhjet e Komitetit Teknik dhe Grupit të Punës mbi pensionet private IOPS/OECD dhe në datën 5 qershor konferencën e IV-të vjetore të Shoqatës Ndërkombëtare Kërkimore për Pensionet. Temat e trajtuara në konferencë ishin:

1. Ndikimet në parashikimet e sëmundjeve dhe vdekshmërisë, në lidhje me programet e pensioneve:
  - Ndarja e riskut të jetëgjatësisë në skemat e pensioneve kolektive, praktika aktuale dhe propozimet për alternativa;
  - Implikimet e progresit të sëmundjeve, vdekshmërisë dhe parashikimet në programet dhe planet e pensioneve;
  - Ndryshimet social-ekonomike në lidhje me vdekshmërinë: tendencat dhe implikimet e fundit të lidhura me programet e pensioneve.

## 2. Marrëveshjet e punës jo standarde dhe të ardhurat e pensionit:

- Mënyrat e sigurimit të pensionit nëpërmjet vetëpunësimit;
- Nëse shefi juaj do të ishte një algoritëm?;
- Zgjerimi i mbulimit të pensioneve tek punonjësit joformalë.

## 3. Pensionet e pastra: Faktorët që pengojnë ofrimin efektiv të të ardhurave nga pensionet:

- Korrupsioni, kapaciteti i shtetit dhe ofrimi i "pastër" i të ardhurave të pensioneve;
- Pensionet e pastra dhe faktorët që pengojnë ofrimin efektiv të të ardhurave nga pensioni;
- Përfaqësimi politik dhe qeverisja: dëshmi të vendimeve të marra nga investimet e fondeve të pensioneve publike.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) do të organizojë në datat 6-8 nëntor 2019 Forumin Global për "Pensionet Private", në bashkëpunim me Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS). Vendimi u mor në mbledhjen e anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv të IOPS-it në 22 shkurt 2018 në Dublin, Irlandë.

Organizimi i një forumi global financiar të këtyre përmasave, i cili zhvillohet për herë të parë në Shqipëri, konsiderohet një zhvillim shumë pozitiv për vendin tonë. Në këtë forum financiar do të marrin pjesë drejtues të lartë të institucioneve financiare dhe autoriteteve rregullatore të vendeve anëtare të IOPS-it. Gjatë datave 6-8 nëntor në Tiranë do të mbahen edhe Mbledhjet e Komitetit Teknik dhe Ekzekutiv si edhe Mbledhja e Përgjithshme me vendet anëtare të IOPS-it.



## Bursa Shqiptare e Titujve ALSE dhe Bursa e Vienës bashkojnë forcat në shpërndarjen e të dhënave për tregun



Të dhënat e tregut të titujve nga Shqipëria mund të aksesohen potencialisht në kohë reale nga më shumë se 18,000 përdorues në rreth 60 vende të ndryshme.

Bursa Shqiptare e Titujve ALSE dhe Bursa e Vienës kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për të dhënat e tregut. Ofruesit e informacionit financiar në treg, të ashtuquajturit shitës të dhënash (*data vendors*), mund të aksesojnë të dhënat e tregut të titujve në Shqipëri nëpërmjet platformës qendrore të shpërndarjes së të dhënave që administron Bursa e Vienës.

Të dhënat e tregut të titujve nga Shqipëria mund të aksesohen potencialisht në kohë reale nga më shumë se 18,000 përdorues në rreth 60 vende të ndryshme. Kjo platformë qendrore e shpërndarjes së të dhënave sipas parimit me një sportel (*one-stop shop*) redukton në maksimum punën për klientët në aspektin administrativ, ligjor dhe teknologjisë së informacionit.

Bursa e Vienës shpërndan të dhëna financiare nga 11 shtete nëpërmjet kësaj platforme qendrore: përditëson të dhënat për tregjet e titujve nga Shqipëria, Austria, Bosnia dhe Hercegovina, Kroacia, Republika Çeke, Hungaria, Kazakistani, Maqedonia e Veriut, Serbia e Sllovenia si dhe të dhënat e tregtimit nga Bursa Austriake e Energjisë (EXAA).

“Me mbështetjen e donatorit zvicerian SECO dhe Bankës Botërore, Shqipëria ka përgatitur projektligje në fushën e fondeve të investimeve dhe në tregun e kapitaleve për të përafuar më shumë legjislacionin shqiptar me direktivat e BE-së. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare po punojnë së bashku për të licensuar dhe mbikëqyrur depozitarin qendror për titujt joqeveritarë, i cili pritet t'i japë një zhvillim të shpejtë tregut të titujve në Shqipëri.

Bashkëpunimi me platformën qendrore të shpërndarjes së të dhënave që administron Bursa e Vienës, do të krijojë një vlerë të madhe në drejtim të rritjes së besimit në tregun vendas si dhe do të ndihmojë në promovimin e tregut të titujve të Shqipërisë në Europë,” thotë Artan Gjergji, Drejtori Ekzekutiv i Bursës Shqiptare të Titujve ALSE.

“Bashkëpunimi ynë me Bursën Shqiptare të Titujve ALSE tregon se si dy bursa mund të përfitojnë nga pikat e forta dhe mundësitë e njëra-tjetrës. Jemi krenarë të ndajmë njohuritë dhe teknologjinë tonë për të rritur vizibilitetin në shkallë ndërkombëtare dhe përafrimin e mëtejshëm me standardet e BE-së të një tregu të rëndësishëm në rajonin e Ballkanit,” u shpreh Ludwig Nießen, Drejtori i Përgjithshëm Operacional dhe Teknik (COO & CTO) i Bursës së Vienës.

## **Kategoritë dhe fazat e tregtimit në Bursë**

*Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare licenoi më datë 3 korrik 2017 shoqërinë “Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE” sh.a. (Albanian Stock Exchange) si bursa e parë shqiptare me kapital privat e licencuar në vend. Në Bursën ALSE tregtohen të gjithë llojet e instrumenteve financiare që njihen nga Ligji nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt” (i ndryshuar), dhe që plotësojnë kriteret e listimit apo kuotimit të përcaktuara në rregulloret përkatëse të ALSE.*

*Si pjesë e rubrikës së “Edukimit të Konsumatorit”, në këtë periodik dhe në vazhdim ne do të sjellim informacione si për nocionet e ndryshme që përdoren në tregtim ashtu edhe informacione statistikore mbi tregtimin në këtë Bursë.*

Tregtimet (transaksionet) në bursë ndahet në dy kategori: Tregtimet në Bursë (*on-exchange*) dhe Tregtimet Jashtë Burse (*off-exchange*).

### **TREGTIMET NË BURSË (ON-EXCHANGE)**

Konsiderohen të gjithë tregtimet që kryejnë anëtarët e bursës gjatë ditëve dhe orareve zyrtare të tregtimit. Si ditë zyrtare të tregtimit janë përcaktuar aktualisht vetëm dy dytë në javë, përkatësisht dita e martë dhe e enjte.

Tregtimi në Bursën ALSE përbëhet nga tre seanca (faza) kryesore:

**Faza e Parahapjes** - mbahet në fillim të çdo dite tregtimi. Në fazën e parahapjes, është i mundur vetëm vendosja dhe modifikimi i urdhrave në sistemin e tregtimit, por ekzekutimi i tregtimit nuk është i mundur. Faza e Parahapjes mbahet ndërmjet orës 10:00-11:59. Kjo fazë përdoret kryesisht për të testuar tregun nëpërmjet kuotimeve me çmime të ndryshme brenda limiteve të përcaktuara të tregtimit ditor.

**Faza Kryesore e Tregtimit** - Pas përfundimit të seancës së Parahapjes, të gjithë urdhrat që janë vendosur në sistem dhe që plotësojnë kushtet e ekzekutimit (përputhshmëri çmimi midis urdhrave të blerjes me ato të shitjes) ekzekutohen menjëherë. Në fazën kryesore të tregtimit është e mundur vendosja dhe modifikimi i urdhrave si dhe çdo urdhër i ri hyrës kontrollohet menjëherë (automatikisht nga sistemi) për ekzekutim të mundshëm përkundrajt urdhrave që janë vendosur në sistemin e tregtimit. Faza Kryesore e Tregtimit është ndërmjet orës 12:00–14:00.

Me përfundimin e fazës kryesore të tregtimit mbaron dhe dita zyrtare e tregtimit. Çmimet e mbylles në fund të ditës së tregtimit do të shërbejnë si çmime reference për ditën pasardhëse.

**Faza e Tregimit jashtë Burse** - Bursa ALSE ka dy intervale gjatë ditëve zyrtare të tregimit për fazën e tregimit jashtë Burse. Faza e parë e tregimit jashtë Burse fillon para nisjes së ditës së tregimit (ndërmjet orës 9:00–10:00) me qëllim që t'u japë mundësi të gjithë anëtarëve të Bursës të raportojnë tregtimet e kryera një ditë më parë kur bursa ka qenë e mbyllur. Faza e dytë e tregimit jashtë burse fillon menjëherë pas përfundimit të fazës kryesore të tregimit (ndërmjet orës 14:00–17:00).

### **TREGTIMET JASHTË BURSE (OFF-EXCHANGE)**

Tregu mbi banak (jashtë orareve zyrtare të tregimit në bursë), karakterizohet nga transaksione të ekzekutuara në kushte të mungesës së transparencës për klientët duke krijuar një ndikim jo pozitiv mbi çmimet e titujve, e jo në pak raste duke ndikuar edhe në deformimin e çmimeve, kosto që bie kryesisht mbi klientët (qytetarët).

Individët apo subjektet që duan të tregtojnë bono dhe obligacione thesari, mund ta bëjnë këtë edhe në ditët e tjera, nëpërmjet bankave që janë Anëtare në Bursën Shqiptare të Titujve ALSE, por më parë duhet të kenë hapur një llogari në cash dhe në tituj si dhe nënshkruar një kontratë për transaksionet që do kryejnë me këto banka.

## **GLOBAL RISK REGULATOR**

Volumi 17, qershor 2019 përmban këto shkrime kryesore:



- Mbretëria e Bashkuar kufizohet se sa larg mund të ndryshojë regjimin rregullator pas Brexit  
*(FCA signals return to principles-based approach post Brexit)*
- BE ndër të tjera shkon drejt një regjimi të kryptoaseteve  
*(EU moves towards its own crypto-asset regime)*


## **JOURNAL OF PENSION ECONOMICS & FINANCE**

Volumi 18, prill 2019 përmban këto shkrime kryesore:

- Efektiviteti i stimujve për të shtyrë pensionin: Evidencë nga Italia  
*(The effectiveness of incentives to postpone retirement: evidence from Italy) IRENE FERRARI*

Ky punim shqyrton nëse stimujt financiarë mund të përdoren si një mjet efektiv për të nxitur punëtorët që të shtyjë kohën e daljes në pension, duke vlerësuar reformën italiane të ashtuquajtur “super-bonus”. Bonusi përbëhet nga stimuj ekonomik të dhënë për një periudhë të kufizuar për punëtorët e sektorit privat, që kanë arritur kërkesat për pensionin e vjetërsisë, por që zgjedhin të shtyjë daljen në pension.

Duke përdorur të dhënat nga një anketim i Bankës së Italisë mbi të ardhurat familjare, punimi studion dhe vlerëson efektin e bonusit në vendimin për shtyrjen e daljes në pension, duke krahasuar punëtorët e sektorëve privatë dhe publikë para dhe pas reformës. Rezultatet sugjerojnë një zvogëlim prej 30% të probabilitetit të pensionimit të vjetërsisë, pavarësisht faktit se kur merren parasysh ndryshimet në sistemin dhe të ardhurat e sigurimeve shoqërore, shpërblimi në të vërtetë ka dhënë një nxitje negative për shumicën e punëtorëve. Rezultatet gjithashtu sugjerojnë se efekti i reformës është nxitur nga punëtorët me të ardhura të ulëta. Në studim evidentohen gjithashtu edhe disa dëshmi që tregojnë se kufizimet e likuiditetit dhe njohuritë dhe edukimi financiar mund të ndihmojnë në interpretimin e këtyre rezultateve.



## **Bullgari**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve në Bullgari për 3-mujorin e parë të vitit 2019 arritën në 748 milionë leva (BNG, monedha vendase) ose rreth 390 milionë euro, me një rritje prej 23%. Primet e shkruara bruto në sigurimin e jetës arritën në 80 milionë euro, me një rritje prej 18.2%. Ndërsa në sigurimin e Jo-Jetës primet e shkruara bruto arritën në 310 milionë euro, me një rritje prej 25%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

## **Hungari**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të Bankës së Hungarisë, primet e shkruara bruto për 3-mujorin e parë të vitit 2019 u rritën me 14.8%, duke arritur në 316.4 miliardë forinta (HUF, monedha vendase) ose 986 milionë euro. Sigurimi i Jetës u rrit me 11.2%, duke arritur në 132 miliardë forinta (411 milionë euro). Ndërsa sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 17.5%, duke arritur në 185 miliardë forinta (575 milionë euro). Në tre muajt e parë të vitit 2019 numri i kontratave të sigurimit u rrit me 4%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në mbi 14 milionë.

## **Rumani**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Primet e shkruara bruto në 3-mujorin e parë të vitit 2019 në tregun e sigurimeve në Rumani u rritën me 27 milionë euro (5%). Sigurimi i Jetës përbën rreth 21.2% të tregut përse i përket primeve të shkruara bruto, ndërsa pjesa tjetër, 78.8%, i përket sigurimit të Jo-Jetës.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës arritën në 121 milionë euro, me një rritje prej 6.4%. Edhe pagesa e dëmeve për sigurimin e Jetës u rrit, duke arritur në 47 milionë euro. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës arritën në 449 milionë euro, me një rritje prej 4.7%. Dëmet e paguara për sigurimin e Jo-Jetës arritën në 282 milionë euro.



## Serbi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të Bankës Kombëtare të Serbisë, primet e shkruara bruto për 3-mujorin e parë të vitit 2019 arritën në 24.83 miliardë dinarë (RSD, monedha vendase) ose 210.5 milionë euro. Përsa i përket dëmeve, shoqëritë e sigurimit paguan 12.28 miliardë dinarë, me një rritje prej 26.2%, kryesisht për shkak të pagesave të dëmeve në sigurimin e pronës.

## Slloveni

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Shoqata e Siguruesve në Slloveni raporton se primet e shkruara bruto arritën në 672.7 milionë euro në 3-mujorin e parë të vitit 2019, me një rritje prej 4.6%. Sigurimi i Jo-Jetës përbën 72.2% të primeve, ndërsa sigurimi i Jetës pjesën tjetër, 27.8%. Përsa i përket dëmeve, siguruesit në Slloveni paguan 400 milionë euro. Nga këto, 135 euro u paguan për sigurimin e Jetës, 123 milionë euro për sigurimin e shëndetit dhe 91 milionë euro për sigurimin motorik.

## Turqi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të Shoqatës së Siguruesve në Turqi, primet e shkruara bruto për 3-mujorin e parë të vitit 2019 arritën në 17.5 miliardë lira (TRY, monedha vendase) ose 2.7 miliardë euro, me një rritje prej 20%. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës arritën në 15 miliardë lira, me një rritje prej 86%. Ndërsa në sigurimin e Jetës primet e shkruara bruto arritën në 2.5 miliardë lira, me një rritje prej 14%.



---

---

## AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)